  - 2) të modifikojë objektin e shoqërisë përmes aktiviteteve të parashikuara duke përfshirë aktivitetin e marrjes me qira, marrjen me qira të anijeve industriale, dhe anije tregtare, me ose pa personel, si dhe marrjen me qira të mjeteve detare dhe tokësore të çdo lloji, përfshirë automjetet industriale, motoskafe, varka, automjete, pajisje dhe makineri për kryerjen e të gjitha punimeve të referuara në objektin e shoqërisë.
  - 3) për të ndryshuar rrjedhimisht nenin 2 në fuqi të Statutit të Shoqërisë, i cili do të jetë si më poshtë: " Neni 2 – Shoqëria ka si objekt ushtrimin e aktiviteteve të mëposhtme:
- Zotërimi, mbajtja dhe administrimi jopublik i pjesëmarrjeve dhe pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, ndërmarrje, konsorciume dhe shoqata të të gjitha llojeve, me të drejtë italiane apo të huaj, të koutuara ose jo, nëpërmjet operacioneve të bashkimit ose ndarjes;

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*Pf*





- Ushtrimi i koordinimit dhe i kontrollit organizativ, tregtar, administrativ dhe financiar i shoqërive pjesëmarrëse me qëllim riorganizimin e shoqërisë nëpërmjet shërbimeve të menaxhimit të thesarit.
- Financimi dhe koordinimi teknik, menaxheuse dhe financiar në mënyrë ekskluzive në favor të shoqërisë ose të enteve në të cilët merr pjesë dhe ofrimi i shërbimeve kundrejt tyre.
- Menaxhimi administrativ i shoqërive në të cilat merr pjesë.
- Kryerja e punimeve të ndërtimit, mirëmbajtjes, rindërtimit në fazën e tenderit, për tratativa private, tendera për punë publike dhe private në sektorin e ndërtimit, punime të rrugëve, ujësjellësave dhe kanalizimeve, trajtimi i mbetjeve urbane solide, linja elektronike, impiante elektrike si dhe përcjellës të çdo lloji.:
  - 1- Punimet e dheut me çdo punim murature dhe betoni të llojit të zakonshëm- prishje dhe gërmime;
  - 2- Ndërtesa civile, industriale, monumente të pajisur me impiante dhe vepra të lidhura, aksesorë- vepra murature për komplekse prodhimi dhe shpërndarje energjie;
  - 3- Punime restaurimi:
    - A. Restaurimi i ndërtesave monumentale;
    - B. Punime dhe gërmime arkeologjike;
  - 4- Punime speciale me beton;
  - 5- Impiante teknologjike dhe speciale- impiante dhe punime parafabrikatesh të ndryshme nga veprat kryesore:
    - A. Impiante ventilimi termik dhe kondicionimi
    - B. Impiante sanitare, hidrosanitare, kuzhina, lavanderi me gaz dhe mirëmbajtja e tyre;
    - C. Impiante elektrike, telefonike, radiotelefonike, televizive dhe të ngjashme dhe mirëmbajtja e tyre;
    - D. Impiante për ashensorë, shkallë të lëvizshme, transportues në përgjithësi;
    - D.1 Administrimi dhe mirëmbajtja e impianteve në fjalë;
    - E. Impiante pneumatike, impiante sigurie dhe mirëmbajtja e tyre;
    - F. Furnizimi dhe instalimi i impianteve prej:
      - 1- hekuri, druri, plastike;
      - 2- materiale guri;
      - 3- materiale qelqi;
    - G. Lyerja dhe lustrimi
    - H. Furnizimi dhe punime për izolimin termik, akustik, kundër zjarrit- punimet e suvatimit dhe papërshkueshmërisë;
  - 6- Ndërtimi dhe shtrimi i rrugëve, instalimi i detektorëve aeroportuale dhe hekurudhorë;
  - 7- Sinjalistika dhe siguria rrugore;
  - 8- Shtrimi me materiale speciale;
  - 9- Vepra hekurudhore:
    - A. Punime dhe mirëmbajtja sistematike e hekurudhave;
    - B. Punime speciale hekurudhore;
    - C. Impiante të sigurisë rrugore;
    - D. Impiante të tërheqjes elektrike;
    - E. Impiante të sistemit të frenimit dhe automatizimi për stacionet e klasifikuara për mallra;
  - 10- Punime hidraulike:
    - A. Ujësjellës dhe kanalizime, impiante vaditëse;
    - B. Punime mbrojtëse dhe impiante hidraulike;
    - C. Gaz, naftë
  - 11- Punime për gjelbërimin bujqësor, pyjor dhe publik;
  - 12- Punime speciale:
    - A. Impiante për mbarështrimin, shndërrimin në ujë të pijshëm dhe filtrimin e ujit;
    - B. Impiante për trajtimin e mbetjeve;
  - 13- Punime detare:

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*ofleg*



- A. Ndërtimi i kalatave, dokeve, argjinaturave, etj.
- B. Punime drenimi
- C. Mirëmbajtja e pajisjeve portuale dhe pastrimi i ujërave portuale;
- 14- Diga;
- 15- Galeri;
- 16- Impiante prodhimi dhe të shpërndarjes së energjisë;
  - A. Impiante hidrologjike;
  - B. Termocentrale;
  - C. Centrale bërthamore;
  - D. Impiante për prodhimin e energjisë nga burime alternative;
  - E. Impiante elektrike për termocentralet elektrike;
  - F. Transformatorë për transformime;
  - G. Linja të tensionit të lartë;
  - H. Linja të tensionit të mesëm dhe të tensionit të ulët;
  - I. Elektroshtëpiake të ndryshme;
  - J. Impiante të ndriçimit;
  - K. Linja telefonike dhe karburanti;
- 17- Punime metalike;
- 18- Impiante telekomunikacioni;
- 19- Punime dhe vepra speciale të ndryshme:
  - A. Rilevime të veçanta topografike;
  - B. Eksplorimi i nëntokës me instrumente të posaçme;
  - C. Ndërrhyrje speciale;
  - D. Konsolidimi i terreneve dhe punime speciale në nëntokë;
  - E. Papërshkueshmëria e terrenit;
  - F. Shpime dhe puse;
- 20- Furnizimi dhe vendosja e impianteve dhe pajisjeve ngritëse dhe të transportit (vinça, trolejbus, teleferik, teleskopa dhe të ngjashëm);
- 21- Punime dhe shitja e inerteve lumore;
- 22- Prodhimi dhe tregtimi i konglomeratëve të çimentos dhe bituminozë;
- 23- Administrimi i shërbimeve portuale dhe shërbimeve turistike në sektorin e ndërtimit;
- 24- Aktivitetet e qirasë, marrja me qira e varkave për turizëm, tregti, industri me dhe pa personel, marrja me qira e anijeve dhe terreneve të çdo lloji, përfshirë mjetet industriale, lundruese, galaktike, tools, pajisjeve dhe zbatimi i të gjitha punimeve të lidhura me objektin e shoqërisë.

Për të përmbushur qëllimin e saj, shoqëria, shoqëria mund të interesohet edhe për fazën e projektimit të punimeve që do të kryhen të fituara në tender.

Gjithashtu mund të blejë, të shesë dhe shkëmbejë terrene dhe zonat ndërimi, të blejë dhe të ndërtojë në toka në pronësinë e saj ose në pronësi të palëve të treta, ndërtesa të natyrës civile, tregtare, industriale dhe bujqësore për rishitjen e tyre mëvonshme dhe për dhënie me qira .

Për të ndjekur qëllimet e lartpërmendura, Shoqëria mund të përmbushë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare (jo kryesore dhe as publike), të pasurive të tundshme dhe të patundshme, të cilat do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, e mbledhjes së kursimeve si dhe aktivitetet për të cilat ligji kërkon një autorizim të posaçëm ose regjistrim; për këtë qëllim, duke respektuar kufijtë e ligjit, shoqëria do të jetë në gjendje të garantojë detyrimet e palëve të treta ose të ortakëve duke dhënë duke lëshuar garanci, garanci personale, garanci reale dhe/ose të detyrueshme.

4. Të miratojë statutin e shoqërisë në formën e lexuar nga Presidenti dhe i koordinuar me vendimin përkatës për objektin e shoqërisë; statuti në fjalë, i përbërë nga 25 (njëzet e pesë)

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*Mjloj*





nene, u miratua shprehimisht nga asambleja, dhe m'u dorëzua mua Noterit për t'u bashkëngjitur nën shkronjën "A" në këtë akt, për ta bërë atë pjesë përbërëse dhe për depozitimin e tij;

5. Të autorizojë Administratorin e Vetëm që të bëjë të gjitha ndryshimet në këtë akt që mund të kërkohen nga autoritetet kompetente gjatë regjistrimit në Regjistrin e Ndërmarrjeve.

Duke mos pasur asgjë tjetër për të diskutuar, pasi asnjë nga të pranishmit nuk e kërkoi fjalën, Presidenti pasi konstatoi rezultatet e votimit, shpalli rezultatet dhe e deklaroi seancën të mbyllur në orën njëmbëdhjetë e dyzet e pesë minuta.

Shpenzimet e këtij akti, relative dhe rrjedhimore, mbulohen nga Shoqëria.

Pala e paraqitur shprehimisht më përjashton nga leximi i shtojcës që i bashkëngjitet këtij akti, duke deklaruar se ka njohuri të sakta.

Unë, Noteri i nënshkruar, kam marrë këtë akt të cilin ia kam lexuar palës së paraqitur, e cila deklaron se e miraton pasi e gjen aktin sipas vullnetit të tij.

Ky akt është pjesërisht i shtypur me makinë shkrimi, nga një person i besuar dhe pjesërisht i plotësuar me dorë nga unë Noteri në dymbëdhjetë faqe me tri fletë, dhe është nënshkruar në orën njëmbëdhjetë e dyzet e pesë minuta.

Nënshkruar nga Giuseppe FRANCO - Francesco PADERNI –  
(Firma, vula).

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*ffly*





Francesco PADERNI –NOTER  
SHTOJCA “A”  
Nr. 4290 i Repertorit  
Nr. 2617 i Koleksionit

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, E EMËRTUAR  
“FRANCO GIUSEPPE S.R.L.”

Neni 1 – Emërtimi

Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “FRANCO GIUSEPPE S.R.L.”

Neni 2-Objekti

Shoqëria ka si objekt ushtrimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- Zotërimi, mbajtja dhe administrimi jopublik i pjesëmarrjeve dhe pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, ndërmarrje, konsorciume dhe shoqata të të gjitha llojeve, me të drejtë italiane apo të huaj, të koutuara ose jo, nëpërmjet operacioneve të bashkimit ose ndarjes;
- Ushtrimi i koordinimit dhe i kontrollit organizativ, tregtar, administrativ dhe financiar i shoqërive pjesëmarrëse me qëllim riorganizimin e shoqërisë nëpërmjet shërbimeve të menaxhimit të thesarit.
- Financimi dhe koordinimi teknik, menaxheuse dhe financiar në mënyrë ekskluzive në favor të shoqërisë ose të enteve në të cilët merr pjesë dhe ofrimi i shërbimeve kundrejt tyre.
- Menaxhimi administrativ i shoqërive në të cilat merr pjesë.
- Kryerja e punimeve të ndërtimit, mirëmbajtjes, rindërtimit në fazën e tenderit, për tratativa private, tendera për punë publike dhe private në sektorin e ndërtimit, punime të rrugëve, ujësjellësave dhe kanalizimeve, trajtimi i mbetjeve urbane solide, linja elektronike, impiante elektrike si dhe përcjellës të çdo lloji:
  - 1- Punimet e dheut me çdo punim murature dhe betoni të llojit të zakonshëm- prishje dhe gërmime;
  - 2- Ndërtesa civile, industriale, monumente të pajisur me impiante dhe vepra të lidhura, aksesorë- vepra murature për komplekse prodhimi dhe shpërndarje energjie;
  - 3- Punime restaurimi:
    - a) Restaurimi i ndërtesave monumentale;
    - b) Punime dhe gërmime arkeologjike;
  - 4- Punime speciale me beton;
  - 5- Impiante teknologjike dhe speciale- impiante dhe punime parafabrikatesh të ndryshme nga veprat kryesore:
    - a) Impiante ventilimi termik dhe kondicionimi;
      - a1) menaxhimi dhe mirëmbajtja e këtyre impianteve.
      - b) Impiante sanitare, hidrosanitare, kuzhina, lavanderi me gaz dhe mirëmbajtja e tyre;
      - c) Impiante elektrike, telefonike, radiotefonike, televizive dhe të ngjashme dhe mirëmbajtja e tyre;
      - d) Impiante për ashensorë, shkallë të lëvizshme, transportues në përgjithësi;
    - d1) Administrimi dhe mirëmbajtja e impianteve në fjalë;
    - e) Impiante pneumatike, impiante sigurie dhe mirëmbajtja e tyre;
    - f) Furnizimi dhe instalimi i impianteve prej:
      - 1- hekuri, druri, plastike;
      - 2- materiale guri;
      - 3- materiale qelqi;
    - g) Lyerja dhe lustrimi

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*ofly*



- h) Furnizimi dhe punime për izolimin termik, akustik, kundër zjarrit- punimet e suvatimit dhe papërshkueshmërisë;
- 6- Ndërtimi dhe shtrimi i rrugëve, instalimi i detektorëve aeroportuale dhe hekurudhorë;
- 7- Sinjalistika dhe siguria rrugore;
- 8- Shtrimi me materiale speciale;
- 9- Vepra hekurudhore:
- a) Punime dhe mirëmbajtja sistematike e hekurudhave;
- b) Punime speciale hekurudhore;
- c) Impiante të sigurisë rrugore;
- d) Impiante të tërheqjes elektrike;
- e) Impiante të sistemit të frenimit dhe automatizimi për stacionet e klasifikuara për mallra;
- 10- Punime hidraulike:
- a) Ujësjiellës dhe kanalizime, impiante vaditëse;
- b) Punime mbrojtëse dhe impiante hidraulike;
- c) Gaz, naftë
- 11- Punime për gjelbërimin bujqësor, pyjor dhe publik;
- 12- Punime speciale:
- a) Impiante për mbarështrimin, shndërrimin në ujë të pijshëm dhe filtrimin e ujit;
- b) Impiante për trajtimin e mbetjeve;
- 13- Punime detare:
- a) Ndërtimi i kalatave, dokeve, argjinaturave, etj.
- b) Punime drenimi
- c) Mirëmbajtja e pajisjeve portuale dhe pastrimi i ujërave portuale;
- 14- Diga;
- 15- Galeri;
- 16- Impiante prodhimi dhe të shpërndarjes së energjisë:
- a) Impiante hidrologjike;
- b) Termocentrale;
- c) Centrale bërthamore;
- d) Impiante për prodhimin e energjisë nga burime alternative;
- e) Impiante elektrike për termocentralet elektrike;
- f) Kabina për transformime;
- g) Linja të tensionit të lartë;
- h) Linja të tensionit të mesëm dhe të tensionit të ulët;
- i) Aparate të ndryshme;
- j) Impiante të ndriçimit të jashtëm;
- k) Linja telefonike dhe vepra të lidhura me to;
- 17- Punime metalike;
- 18- Impiante telekomunikacioni;
- 19- Punime dhe vepra speciale të ndryshme:
- a) Rilevime të veçanta topografike;
- b) Eksplorimi i nëntokës me instrumente të posaçme;
- c) Ndërhyrje speciale;
- d) Konsolidimi i terreneve dhe punime speciale në nëntokë;
- e) Papërshkueshmëria e terrenit;
- f) Shpime dhe puse;
- 20- Furnizimi dhe vendosja e impianteve dhe pajisjeve ngritëse dhe të transportit (vinça, trolejbus, teleferik, teleskopa dhe të ngjashëm);
- 21- Punime dhe shitja e inerteve lumore dhe guroveve;
- 22- Prodhimi dhe tregtimi i konglomeratëve të çimentos dhe bituminozë;
- 23- Administrimi i shërbimeve portuale dhe shërbimeve turistike në sektorin e ndërtimit;

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*Myly*





24- Aktivitetet e qirasë, marrja me qira e varkave për turizëm, tregti, industri me dhe pa personel, marrja me qira e anijeve dhe terreneve të çdo lloji, përfshirë mjetet industriale, lundruese, galaktike, tools, pajisjeve dhe zbatimi i të gjitha punimeve të lidhura me objektin e shoqërisë.

Për të përmbushur qëllimin e saj, shoqëria, shoqëria mund të interesohet edhe për fazën e projektimit të punimeve që do të kryhen të fituara në tender.

Gjithashtu mund të blejë, të shesë dhe shkëmbejë terrene dhe zonat ndërimi, të blejë dhe të ndërtojë në toka në pronësinë e saj ose në pronësi të palëve të treta, ndërtesa të natyrës civile, tregtare, industriale dhe bujqësore për rishitjen e tyre mëvonshme dhe për dhënie me qira.

Për të ndjekur qëllimet e lartpërmendura, Shoqëria mund të përmbushë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare (jo kryesore dhe as publike), të pasurive të tundshme dhe të patundshme, të cilat do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit të shoqërisë, e mbledhjes së kursimeve si dhe aktivitetet për të cilat ligji kërkon një autorizim të posaçëm ose regjistrim; për këtë qëllim, duke respektuar kufijtë e ligjit, shoqëria do të jetë në gjendje të garantojë detyrimet e palëve të treta ose të ortakëve duke dhënë duke lëshuar garanci, garanci personale, garanci reale dhe/ose të detyrueshme.

### Neni 3- Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në Rocella Ionica (RC) dhe mund të hapë stabilimente dhe zyra administrative, agjenzi dhe degë tregtare, filiale kudo ku do ta gjykojë të të përshtatshme.

### Neni 4- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është përcaktuar deri më 31 dhjetor 2100, përveç rasteve të shtyrjes ose të shkrijës së parakohshme.

### Neni 5-Kapitali

5.1 Kapitali i shoqërisë është 1.300.000,00 Euro (një milion e treqind mijë euro), i ndarë në kuota.

5.2 Përveç rastit të parashikuar në nenin 2482 ter të Kodit Civil rritjet e kapitalit mund të kryehet edhe nëpërmjet ofërësë së pjesëmarrjeve në kapitalin e sapoemeluar për palët e treta; në këtë rast, u takon ortakëve të cilët nuk kanë kontribuar në vendim, e drejta e tërheqjes sipas nenit 2473 të Kodit civil.

5.3 Kapitali mund të rritet edhe nëpërmjet kontributeve në mallra, kredi, ofrimit të punës ose shërbimeve dhe nëpërmjet çdo gjëje që është e ndjeshme ndaj vlerësimit ekonomik, por gjithmonë në kufijtë e parashikuar nga ligji.

Vendimi për rritjen e kapitalit duhet të përcaktojë mënyrat e kontributit, në mungesë të ndonjë udhëzuesi kontributi do të bëhet betëm në para.

Në rast të kontributit nëpërmjet ofrimit të punës ose të shërbimeve nevojitet ofrimi i një police sigurimi ose e një garancia bankare dhe kjo me qëllim që të garantojë të gjithë vlerën e ofruar, detyrimet e marra nga ortaku që ka për objekt ofrimin e punëve ose të shërbimeve; në këtë rast polica e sigurimit ose garancia bankare mund të zëvendësohen nga ortaku me derdhjen e kaucionit me depozitim të shumës përkatëse në para në shoqëri.

5.4 Në rast të reduktimit për shkak të humbjeve të cilat ndikojnë në kapitalin e shoqërisë për më shumë se një të tretën, mund të tërhiqet depozita e dokumnetacionit të parashikuar nga neni 2482 –bis, pika 2 e Kodit civil, pranë selisë së shoqërisë, në parashikim të asamblesë së parashikuar.

5.5 Financimet e mundshme të bëra në shoqëri nga ortakët mund të jenë produktive të interesave, masa e të cilave ose përjashtimi do të duhet të përcaktohet, herë pas here, nga asambleja e ortakëve në zbatim dhe për efektet e ligjit 385/1993 dhe në bazë të vendimeve të CICR(Komiteti Ndërmintorror për Kreditë dhe Kursimet) datë 03/03/1994, me dispozitën zbatuese të botuar në GUR (Fletoren zyrtare), datë 12/12/1994 të Bankës së Italisë.

### Neni 6- Transferimi i aksioneve me akt ndërmjet personave të gjallë.

Përktheu: Valentina JAUPI

Valentina Jaupi





6.1 Mënyra ë të thënit "transferimi i aksioneve me akt ndërmjet personave të gjallë", nënkupton të përfshira të gjitha negocimet për tjetërsimin, në kuptimin më të gjerë të termit pavarësisht shkakut. Në të gjitha rastet, në të cilët natyra e negociimit nuk parashikon një korrespondues ose një korrespondues të ndryshëm nga paraia, u takon ortakëve e drejta e parablerjes, e cila duhet të ushtrohet sipas procedurës së përshkruar më sipër, dhe po të njëjtët do të bëjnë aksionin duke i derdhur ofruerit shumën e përcaktuar me marrëveshje të përbashkët, ose në mungesë të marrëveshjes, nga një ekspert i regjistruar në urdhrin e kontabilistëve, i cili do të emërohet nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit ku ndodhet selia e shoqërisë.

6.1.2 Ortakuvë u njihet e drejta e parablerjes së kuotave të shoqërisë objekt transferimi me akt ndërmjet personave të gjallë.

Kjo e drejtë mund të ushtrohet me të njëjtin çmim dhe kushte, në masë proporcionale me kuotat që secili prej tyre zotëron. Gjithmonë me kriterin analog proporcional do të blihen ato kuota (ose fraksione të tyre) mundësisht të pazgjidhura. Për të mundësuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes përcaktohet procedura e përmendur më poshtë, pa paragjykuar parimin se natyra dhe efektiviteti i një "propozimi kontraktual" i atribuohet komunikimit që u dërgohet ortakëve për qëllime të ushtrimit të kësaj të drejte, dhe kjo në të gjitha rastet, dhe për rrjedhojë edhe kur propozimi i shitjes formulohet drejtpërdrejt nga zotëruerit i kuotës, edhe në rastin kur jëta u komunikojnë ortakëve një propozim të hartuar nga palë të treta.

me qëllim që të mundësohet ushtrimi i kësaj të drejte, përcaktohet procedura e mëposhtme:

Ortaku që ka për qëllim të tjetërsojë kuotën e tij të përfaqësimit në shoqëri, ose një pjesë të saj, duhet të njoftojë të gjithë ortakët e tjerë me letër rekomande me mandat pranimit pa kthim të zarfit, dërguar në adresën që rezulton në regjistrin e shoqërive, duke treguar kuotën shoqërore që dëshiron të transferojë, çmimin e kërkuar, mënyrën e pagesës, kushte të mundshme të veçanta, emrin e blerësit.

Brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga marrja e këtij komunikimi, ortakët që dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, duhet, që t'i komunikojnë propozuesit vendimin e tyre të përvokueshëm, me letër rekomande me faturë kthimi pa zarf, këtij komunikimi i atribuohet që nga ky moment natyra e "pranimit të ofertës" dhe në këtë rast cedimi i aksioneve duhet të formalizohet brenda pesëmbëdhjetë ditëve, duke nisur nga kjo datë.

6.1.3 Në hipotezën e transferimit të kryer pa respektuar sa më sipër, blerësi, nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtës së votës dhe të të drejtave të tjera administrative dhe nuk mund të tjetërsojë aksionin me efekt drejt shoqërisë.

6.2.1 Ortaku ose ortakët që deklarojnë se dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, ose kur mendojnë se çmimi i kërkuar është i tepruar, do të kenë të drejtën të kërkojnë brenda tridhjetë ditëve, nën sanksionin e dekadencës që ky çmim të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga Kryetari i gjykatës së rrethit ku ndodhet selia e shoqërisë.

6.2.2 E drejta e parablerjes u takon ortakëve edhe kur ka për qëllim të transferojë pronësinë e zhveshur të aksionit. E drejta e parablerjes nuk u takon për rastin e pengut ose të uzufuktit.

6.3 Kuotat mund të transferohen lirisht vetëm në rastet e mëposhtme:

a) në rastin e një ortaku person fizik: në favor të ortakëve të tjerë ose tek të afërmit e tij brenda familjes.

### Neni 7- Vdekja e ortakut

Në rast të vdekjes së njërit prej ortakëve, trashëgimtarët e ortakut të ndjerë kanë mundësinë që të futen në shoqëri ose të kërkojnë likuidimin e kuotës që i përket ortakut të ndjerë, por me detyrimin që t'u bëjnë të njohur, këtë vendim ortakëve të tjerë, brenda tre muajve nga vdekja e personit të tyre. Pasi ka kaluar në mënyrë të pafrutshme ky afat, asambleja e ortakëve do të marrë masa që d'u t'i duken më të përshtatshme në interes të shoqërisë, dhe trashëgimtarët do të jenë të detyruar që të pajtohen me ato masa, pa përjashtim dhe pa asnjë rezervë, pasi ka përjashtuar çdo veprim pasues në këtë drejtim.

Nëse do të procedohet me likuidimin e kuotës dhe të fitimeve që i takojnë ortakut të ndjerë, ky likuidim do të duhet të kryhet për një të tretën brenda një viti nga vdekja e për pjesën e mbetur dy të tretat në dy vitet në vazhdim pas vdekjes.

Likuidimi i kuotës do të duhet të kryhet bazuar në vlerën e tregut të kuotës në kohën e vdekjes. Kjo

Përktheu: Valentina JAUPI

Valentina Jaupi  
Pjebaj





klauzolë, e cila ka karakter thelbësore dhe të detyrueshëm, vendoset për të shmangur çdo kundërshtim ndërmjet ortakëve të mbijetuar dhe trashëgimtarëve të ortakut të ndjerë.

#### Neni 8-Tërheqja

Ortakët kanë të drejtë të tërhiqen në përputhje me dypsozitat e nenit 2473 të Kodit civil. Nëse do të procedohet me likuidimin e kuotës dhe të fitimeve që i takojnë ortakut të tërhequr, ky likuidim do të duhet të kryhet sipas parashikimeve të normave ligjore në fuqi në këtë fushë.

#### Neni 9- Administratorët

9.1 Shoqëria mund të administrohet, në mënyrë alternative, në bazë të vendimeve të ortakëve, në momentin e emërimit:

- a. nga një administrator i vetëm;
- b. nga një këshill administrativ i përbërë nga shumë anëtarë, sipas numrit të përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit.
- c. nga dy ose më shumë administratorë me kompetenca të përbashkëta, të ndara os e që t'i ushtrijnë ato si mazhornacë.

9.2 Administratorët mund të jenë edhe ortakë.

9.3 Administratorëve nuk u ndalohet e drejta e konkurimit sipas nenit 2390 të Kodit civil.

#### Neni 10- Kohëzgjatja në detyrë, revokimi, shkarkimi

10.1 Administratorët janë në detyrë deri në revokimin osë dorëheqjen e tyre ose për periudhën e përcaktuar nga ortakët në momentin e emërimit.

10.2 Administratorët kanë të drejtën e rizgjedhjes.

10.3.1 Shkarkimi i administratorëve për ëprfundim të afatit ka efekt nga moment në të cilin konstituoehet organi i ri administrative.

10.3.2 Përveç sa parashikohet në pikën në vijim, nëse gjatë vitit ushtrimor mungojnë një ose më shumë administratorë, të tjerët marrin masa që t'i zëvendësojnë; administratorët e emëruar në këtë mënyrë do të qëndrojnë në detyrë deri në asamblenë e ardhme.

10.3.3 Në rast të emërimit nga këshilli i administrimit, nëse për çfarëdo arsyeje paraqitet më pak se gjysma e këshilltarëve, në rast të numrave çift, ose të mazhorancës së tyre, zbatohen dispozitat e nenit 2386 të Kodit civil.

#### Neni 11- Këshilli i administrimit dhe takimet

11.1 Nëse ortakët nuk e kanë bërë këtë në kohën e emërimit, këshilli i administrimit zgjedh në mes të anëtarëve të tij një president.

11.2 Në rast kërkese nga dy administratorë, këshilli i administrimit duhet të vendosë në një takim kolegjal.

11.3 Në këtë rast, Presidenti thërret këshillin e administrimit, cakton rendin e ditës, koordinon punët dhe merr masat që të gjithë administratorët të informohen në mënyrë të përshtatshme për të gjitha çështje që do të trajtohen.

11.4 Thirrja bëhet nëpërmjet njoftimit të dërguar të gjithë administratorëve, audituesve efektivë dhe revizorit, nëse ka të tillë të emëruar, me çfarëdo mjeti të përshtatshëm që të garantojë provën e marrjes së njoftimit, për këtë qëllim konsiderohen mjete të përshtatshme dërgimi me fax dhe me rrugë elektronike.

Njoftimi duhet të dërgohet të paktën tetë ditë para takimit dhe në rast urgjence, të paktën dy ditë para. Në njoftim përcaktohen data, vendi dhe ora e takimit, si dhe rendi i ditës.

11.5 Këshilli i administrimit mbledhet në selinë e shoqërisë ose gjetkë, mjafton që të jetë në Itali.

11.6 Mbledhjet e këshillit të administrimit dhe vendimet e tij janë të vlefshme edhe pa njoftim

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*JAUPI*





formal, kur marrin pjesë të gjithë këshilltarët në detyrë dhe audituesit efektivë, nëse ka të emëruar.  
11.7 Vendimet e këshillit të administrimit merren me votën e shumicës së anëtarëve të tij, në detyrë.  
11.8 Për vendimet e mbledhjes do të hartohet një process-verbal i firmosur nga Presidenti dhe nga sekretari nëse ka të emëruar, i cili duhet të regjistrohet në librin e vendimeve të administratorëve.  
11.9 Këshilli mund të mbledhet dhe të vendosë në mënyrë të vlefshme edhe nëprmet mjeteve të telekomunikacionit, me kusht që të ekzistojnë garancitë e parashikuar në lidhje me asamblenë.

### Neni 12- Të drejtat e organit administrativ

12.1 Administratori ose këshilli është i veshur me kompetencat më të gjera për menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe ka për detyrë të përmbushë të gjithë aktet e nevojshme dhe të të përshtatshëm për zbatimin dhe arritjen e objektit të shoqërisë, përjashtuar vetëm ato të cilat ligji ia rezervon asamblesë së ortakëve në formë të detyrueshme.  
12.2 Në rast të emërimit të këshillit të administrimit, ky mund të delegojë të gjitha ose një pjesë të kompetencave të tij një komiteti ekezekutiv i përbërë nga disa prej anëtarëve të tij, ose një ose më shumë anëtarëve të tij, edhe veçmas. Në këtë rast zbatohen dispozitat e parashikuara në pikat tre, pesë dhe gjashtë të nenit 2381 të Kodit civil. Nuk mund të delegohen atributet e parashikuara nga neni 2475, pika pesë e Kodit civil.  
12.3 Në rast se kemi një këshill administrimi të përbërë nga nga dy anëtarë, nëse administratorët nuk janë dakord për shkarkimin e mundshëm të një prej administratorëve të deleguar, të dy anëtarët e këshillit e humbasin funksionin dhe brenda tridhjetë (30) ditëve duhet t'i nënshtrohen vendimit të ortakëve për emërimin e një organi të ri administrativ.  
12.4 Në rast të emërimit të më shumë administratorëve, në momentin e emërimit, të drejtat e administrimit mund t'u atribuohen atyre bashkarisht, veçmas ose me shumicë, ose dias të drejta të administrimit mund t'u atribuohen veçmas dhe disa të tjera bashkarisht.  
Në mungesë të çfarëdo saktësimi në aktin e emërimit, në lidhje me mënyrat e ushtrimit të kompetencave të administrimit, këto kompetenca konsiderohen se u atribuohen administratorëve bashkarisht.  
Në rast të administrimit të përbashkët, administratorët vetëm nuk mund të kryejnë asnjë veprim, përveç në rastet kur nevojitet të veprohet me urgjencë për të mënjanuar dëmet kundrejt shoqërisë.  
12.5 Mund të emërohen drejtorë, përfaqësues me prokurë ose përfaqësues për përmbushjen e akteve të caktuara ose të kategorive të akteve, duke përcaktuar të gjitha të drejtat.  
12.6 Kur administrimi u besohet veçmas disa administratorëve, në rast se një administrator kundërshton një operacion që një tjetër synon ta realizojë, ortakët janë kompetentë për të vendosur për kundërshtimin.

### Neni 13- Përfaqësimi

13.1 Administratori i vetëm përfaqëson shoqërinë.  
13.2 Në rast të emërimit të këshillit të administrimit, përfaqësimi i shoqërisë i takon presidentit të këshillit të administrimit dhe këshilltarëve të tjerë të deleguar edhe për akte të veçantës, nëse emërohen.  
13.3 Në rast të emërimit të disa administratorëve, përfaqësimi i shoqërisë u takon atyre bashkarisht ose të ndarë, në të njëjtën mënyrë në të cilën janë atribuar në vendimin e emërimit të drejtat e administrimit.  
13.4 Përfaqësimi i shoqërisë u takon edhe drejtorëve, përfaqësuesve me prokurë dhe avokatëve, në kufijtë e kompetencave të dhëna atyre në aktin e emërimit.

### Neni 14- Shpërblimi i administratorëve

14.1 Administratorëve u takon rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsye të detyrës së tyre.  
14.2 Ortakët mund t'u caktojnë ndër të tjera administratorëve një shpërblim vjetor në masë fikse, ose një shpërblim proporcional me fitimet neto të vitit ushtrimor, si dhe të përcaktojnë një dëmshpërblim

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*





për shkarkimin nga detyra dhe të vendosin për një provizion për fondin e pensionit përkatës sipas mënyrave të përcaktuara me vendim të ortakëve.

14.2 Në rast të emërimit të një komiteti ekzekutiv ose të këshilltarëve të deleguar, shpërblimi i tyre përcaktohet nga këshilli i administrimit në momentin e emërimit.

#### Neni 15- Organi i kontrollit

15.1 Kur ortakët e shohin mundësinë mund të emërojnë një organ të kontrollit ose një revizor. Emërimi i organit të kontrollit ose i revizorit është i detyrueshëm në rastet e parashikuara nga ligji. Organi i kontrollit përbëhet, në mënyrë alternative, me vendim të ortakëve në aktin e emërimit, nga një anëtar efektiv ose nga një kolegji, i përbërë nga tre anëtarë efektivë dhe dy zëvendësues.

15.2 Në rast të emërimit të një organi kontrolli, edhe me një anëtar, zbatohen dëpsozitat për bordin e audituesve për shoqëritë aksionere. Organi i kontrollit ose revizori duhet të zotërojë kërkesat dhe kanë kompetencat dhe të drejtat e parashikuara nga dispozitat për bordin e audituesve për shoqëritë aksionere.

15.3 Revizionimi ligjor i llogarive të shoqërisë ushtrohet, sipas gjykimit të ortakëve dhe në varësi të dispozitave të detyrueshme të ligjit, nga një revizor ligjor ose nga një shoqëri audituese e regjistruar në regjistrin e poasçëm ose nga organi i kontrollit atje ku lejohet me ligj. Mbledhjet e organit të kontrollit të përbërë nga shumë anëtarë mund të zhvillohen nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit, në respektim të parashikimeve për mbledhjet e këshillit të administrimit.

#### Neni 16-Vendimet e ortakëve

16.1 Ortakët vendosin për lëndët e rezervuar për kompetencat e tyre nga ligji, nga ky statut, si dhe për argumentet që një ose disa administratorë ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë paraqesin për miratimin e tyre.

16.2 Nuk nevojitet vendimi i ortakëve që autorizon blerjen nga ana e shoqërisë, për një shumë korresponduese ta barabartë ose më të madhe se një e dhjeta e kapitalit të shoqërisë, të pasurive ose të kredive të ortakëve themelues, të ortakëve dhe të administratorëve, në dy viete pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin e ndërmarrjeve.

16.3 Përveç parashikimit në pikën një të nenit të mëposhtëm 18, vendimet të cilat në zbatim të ligjit ose në zbatim të këtij Statuti, nuk duhet të miratohen me vendim të asamblesë, mund të miratohen nëpërmjet konsultimit me shkrim të ortakëve.

Mund të marrin pjesë në procesin e vendimeve të gjithë ortakët me të drejtë vote. Dokumenti i cili përmban objektin e shoqërisë në lidhje me të cilin kërkohet vendimi i ortakëve, me treguesin e mundshëm të propozimit midis alternativave të tyre u dërgohet, nën kujdesin e Organit Administrativ, secilit prej ortakëve në adresën që rezulton në regjistrin e shoqërive, si dhe administratorëve jo ortakë dhe anëtarëve të bordit të audituesve, me letër rekomande A.R. ose me çfarëdo mjet tjetër që garanton provën e marrjes së saj.

Në afatin kohor prej pesëmbëdhjetë ditë nga marrja e këtij propozimi, secil ortak, me mënyrat e parashikuara në pikën më sipër duhet të dërgojë pranë selisë së shoqërisë një dokument, të pajisur me datë dhe të nënshkruar prej tij, nga i cili të rezultojë me qartësi argument object i vendimit dhe pozicioni i shprehur i tij. Ndërmjet datës së parë dhe të fundit të nënshkrimit nuk mund të kalojë një periudhë më e lartë se tetë ditë.

Vendimi do të konsiderohet i miratuar në mënyrë të vlefshme kur midis afatit sipas pikës së mësipërme vjen në shoqëri konsensusi i shumicës që përfaqëson të paktën pesëdhjetë e një përqind të kapitalit dhe u komunikohet ortakëve nën kujdesin e Organit të Administrimit.

Organi i Administrimit do të kujdeset që të hartojë një proces-verbal të poasçëm, që do të regjistrohet në librin e vendimeve të ortakëve, nga i cili duhet të rezultojë argument object i vendimit, rezultatet e votimit të tij, përmendja e ortakëve në favor, kundër dhe /ose abstenues, me kërkesë të tyre, treguesi i motivit të vendimit të tyre. Kopja e process-verbalit do t'u dërgohet të gjithë ortakëve dhe nëse parashikohet nga ligji, do të depozitohet për regjstrim në Regjistrin e Shoqërive.

16.4 Vendimet të cilat sipas ligjit ose sipas këtij Statuti nuk duhet të merren me vendim të asamblesë

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*JAUPI*





mund të merren nëpërmjet konsensusit të shprehur me shkrim nga ortakët. Secili ortak, në mungesë të konsultimit praparak, mund të paraqesë para ortakëve të tjerë një argument të përcaktuar për të cilin vullneti i shoqërisë formohet nëpërmjet mbledhjes progressive të konsensusve të gjithësecilit ose nëpërmjet nënshkrimit, nga ana e të gjithë ortakëve me pëlqim, të një dokumenti unik të redaktuar nën kujdesin e ortakut propozues dhe që u dërgohet ortakëve me mënyrat e paarshikuara në nenin 16.3.

Për këtë procedurë të shprehjes së vullnetit të shoqërisë zbatohen dispozitat e nenit të mësipërm 16.3. 16.5 Në rast mosveprimi nga organi administrative, aktivizimi i procedimit të vendimit jashtë asamblesë, si dhe process-verbali i të njëjtës kërkesë, mund të promovohet dhe/ose zbatohet respektivisht nga secili prej ortakëve.

Për qëllime të kësaj pike, organi administrativ do të konsiderojë si mosveprim pas kalimit të periudhës prej pesëmbëdhjetë ditëve nga komunikimi, me letër rekomande a.r, nga kërkesa e aktivizimit të procedimit dhe.ose nga kërkesa e regjistrimit në process-verbal të kërkesës përkatëse.

### Neni 17 – E drejta e votës

- 17.1 Kanë të drejtën e votës ortakët që rezultojnë të tillë sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 17.2 Vota e ortakut vlen në masë proporcionale me aksionet e tij.

### Neni 18-Asambleja

18.1 Asambleja duhet të thirret nga organi administrativ edhe jashtë selisë së shoqëqrisëm mjafton që të jetë në Itali.

Në rast të pamundësisë së të gjithë administratorëve ose të pasivitetit të tyre asambleja mund të thirret nga bordi i audituesve, nëse ka të emëruar, ose nga një ortak në mënyrat e paarshikuara nga ligji. Asambleja mund të thirret të paktën një herë në vit për miratimin e bilancit.

18.2 Asambleja thirret me njoftim të dërguar tetë ditë para ose, nëse dërgohet më pas, duhet të merret të paktën pesë ditë para nga dita e caktuar për takimin, me letër rekomande, ose me çfarëdolloj mjete tjetër të përshtatshëm që garanton provën e marrjes, që të merret nga ata që kanë të drejtë në adresën që rezulton në librat e shoqërisë dhe në regjistrin e shoqërive. Në njoftimin e thirrjes duhet të tregohen dita, vendi, ora e takimit si dhe lista e argumenteve që do të trajtohen.

Në njoftimin e thirrjes mund të parashikohet një datë e mëvonshme për një thirrje të dytë, në rast se takimi i parashikuar në thirrjen eparë asambleja nuk rezulton të jetë konstituar ligjërisht; gjithsesi edhe në thirrjen e dytë vlejnjë të njëjtat shumica të parashikuara në thirrjen e parë.

18.3 Edhe në mungesë të thirrjes formale asambleja konsiderohet e konstituar rregullisht kur marrin pjesë i gjithë kapitali i shoqërisë dhe të gjithë administratorët dhe audituesit, nëse ka të emëruar, janë të pranishëm os etë informuar dhe askush prej tyre nuk kundërshton trajtimin e argumentit. Nëse administratorët ose audituesit, nëse ka të emëruar, nuk marrin pjesë personalisht në asamble, duhet të lëshojnë deklaratë të poasçme me shkrim, e cila do të ruhet në aktet e shoqërisë, në të cilën ata deklarojnë se janë informuar për mbledhjen, për të gjithë argumentet në rendin e ditës dhe se nuk kundërshtojnë trajtimin e tyre.

### Neni 19- Zhvillimi i asamblesë

19.1 Asambleja kryesohet nga administratori i vetëm, nga presidenti i këshillit të administrimit ( në rast të emërimit të këshillit të administrimit) ose nga administratori më i moshuar ( në rast të emërimit të shumë administratorëve me të drejta të ndara ose të përbashkëta). Në rast të mungesës ose të pamundësisë së tyre, asambleja kryesohet nga një person i zgjedhur nga të pranishmit.

19.2 Asambleja e ortakëve mund të zhvillohet edhe në shumë vende, të lidhura me audio ose video, dhe kjo në kushtet e mëposhtme, për të cilat duhet të mbahet akt në proces-verbalet përkatëse:  
- që të jenë të pranishëm në të njëjtin vend presidenti dhe sekretari i mbledhjes, nesë ka një sekretar të emëruar, të cilët do të kujdesen për hartimin dhe nënshkrimin e proces-verbalit.  
- që ti lejohet presidentit të asambles të vërtetojë identitetin dhe legjitimitimin e të pranishmëve , të rregullojë zhvillimin e takimit, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit.

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*





- që t'i lejohet sekretarit që mban proces-verbalin që të konceptojë në mënyrë të përshtatshme ngjarjet e asambles objekt i hartimit të proces-verbalit.
  - që t'u lejohet të pranishmëve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin e njëkohshëm për argumentet në rend të ditës, si dhe të shohin, marrin dhe përcjellin dokumentet.
  - Që thirrja e njoftimit të përmbajë vendet audio dhe ose video të lidhura nën kujdesin e shoqërisë, në të cilat të pranishmit mund të marrin pjesë, pasi takimi konsiderohet se është zhvilluar ku presidenti është i pranishëm ose presidenti dhe sekretari, nëse ka të emëruar janë të pranishëm.
- Në të gjitha vendet të lidhura me audio dhe ose video në të cilat mbahet mbledhja duhet të mbahet listë prezenca.

### Neni 20- Delegimet

- 20.1 Secili ortak, i cili ka të drejtë të ndërhyjë në asamble mund të përfaqësohet edhe nga një subjekt jo ortak me prokurë me shkrim, e cila duhet të ruhet nga shoqëria. Në prokurë duhet të përcaktohet emri i përfaqësuesit së bashku me kompetencat e mundshme dhe kufizimet e nëndelegimit.
- 20.2 Nëse prokura është dhënë vetëm për asamblenë ajo ka efekt edhe për thirrjen e dytë.
- 20.3 Pranohet edhe një prokurë që vlen për shumë asamble, pavarësisht rendit të tyre të ditës.

### Neni 21- Kuorumi konstituiv dhe vendimarrës

- 21.1 Asambleja konstituohet rregullisht me praninë e shumë ortakëve, të cilët përfaqësojnë të paktën pesëdhjetë e një përqind të të gjithë kapitalit të shoqërisë dhe vendos me shumicën absolute të votave, përveç në rastet e parashikuara nga pikat 4 dhe 5 të nenit 2479, për të cilat nevojitet një shumicë e cila përfaqëson të paktën 51% (pesëdhjetë e një për qind) të kapitalit të shoqërisë.
- 21.2 Megjithatë mbeten në fuqi dispozitat e tjera të ligjit ose të këtij statuti, të cilat për vendime të veçanta kërkojnë disa shumica specifike.
- 21.3 Në rastet kur në bazë të ligjit ose në bazë të këtij statuti e drejta e votës së pjesëmarrjes pezullohet (për shembull në rast konflikti interesi ose të ortakut që ka ndërruar jetë), zbatohen dispozitat e nenit 2368, pika 3 të Kodit civil.

### Neni 22- Bilanci dhe fitimet

- 22.1 Vitet ushtrimore mbyllen më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.
- 22.2 Bilanci duhet të miratohet brenda njëqind e njëzet ditëve ose brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve në rast të ekzistencës së kërkesave të ndryshme.
- 22.3 Kur kapitali i shoqërisë është caktuar në masën më të vogël se 10.000,00 (dhjetë mijë/00) Euro, duhet të lihet në rezervën ligjore një shumë e barabartë të paktën me një të pestën e fitimeve neto që rezultojnë nga bilanci deri sa vetë rezerva të mos ketë arritur, së bashku me kapitalin, shumën prej 10.000,00 Euro (dhjetë mijë/00).
- Rezerva e formuar në këtë mënyrë mund të përdoret vetëm për t'u atribuar në kapitalin e shoqërisë dhe për të mbuluar humbje të ndryshme.
- Kjo rezervë duhet të riintegrohet në përputhje me dispozitat e pikës 5 të nenit 2463 të Kodit civil, në rast të reduktimit për çfarëdo lloj arsyeje.
- Kur kapitali i shoqërisë është përcaktuar në masën e barabartë ose më të lartë nga 10.000,00 (dhjetë mijë/00) Euro se fitimet neto që rezultojnë nga bilanci, duhet të lihet në rezervën ligjore një shumë e barabartë të paktën me 5% (pesë për qind) e fitimit deri sa vetë rezerva të mos ketë arritur, së bashku me kapitalin, një të pestën e kapitalit.
- Fitimet që mbeten do të shpërndahen midis ortakësve në masë proporcionale me pjesën që secili prej tyre zotëron, përveç një vendimi ndryshe të ortakëve.

### Neni 23- Shpërndarja dhe likuidimi

- 23.1 Shoqëria shpërndahet për arsyet e parashikuara nga ligji.
- 23.2 Shoqëria mund të shpërndahet në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye, Asambleja me shumicën e

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*  
*gje*





parashikuara nga ligji, emëron një ose disa likujdues duke përcaktuar kompetencat dhe duke saktësuar gjithashtu mënyrat e likuidimit, i cili mund të bëhet nëpërmjet caktimit ortakëve të aktiveve në natyrë.

#### Neni 24- Klauzola e pajtimit

Të gjitha konfliktet, që kanë për objekt të drejta të disponueshme dhe sadopak të ndjeshme për t'u përcaktuar në rrugë arbitrale ose pajtuese, që mund të ndodhin midis ortakëve, midis ortakëve dhe shoqërisë, dhe midis ortakëve dhe organit administrativ dhe /ose të kontrollit duhet t'i dërgohen paraprakisht një autoriteti ndërmjetësues të akredituar pranë Ministrisë së Drejtësisë, i cili do të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët midis palëve brenda tridhjetë ditëve duke fillura nga data e kërkesës së njëres prej palëve, ose, në mungesë, pasi kalimit të kësaj periudhe, nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit ku ndodhet selia e shoqërisë, në përputhje me dekretin legjislativ 28/2010 dhe ndryshimet e tij dhe /ose shtesat.

#### Neni 25- Dispozitat e shtyrjes

Për gjithçka që nuk është parashikuar nga ky statut, shoqëria u referohet normave të parashikuara nga Kodi civil për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe kur këto nuk përshikojnë asgjë, normave të parashikuara për shoqëritë aksionare, si të pajtueshme.

KJO KOPJE, E PËRBËRË NGA DYZET E DY FAQE DUKE PËRFSHIRË EDHE KËTË, ËSHTË NË ËPRËPËRË NË ORIGINALIN QË RUHET NË AKTET E MIA. LËSHOHET NË LETËR TË THJESHTË PËR PËRDORIMET E PARASHIKUARA NË TABELËN "B" BASHKËLIDHUR DEKRETI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS, NR.642, DATË 26 TETOR 1972.

Locri, më 22 shtator 2015.

NOTERI

(Firma, vula)

REPUBLIKA ITALIANE  
PROKURORIA E REPUBLIKËS LOCRI  
RAJONI REGGIO CALABRIA

VULA APOSTILLE  
(Konventa e Hagës 5 Tetor 1961)

- 1- Republika Italiane  
**Ky akt publik:**
- 2- Është nënshkruar nga: **Stefano PADERNI** në datën 22/09/2015
- 3- Në cilësinë e **Noterit në Locri (RC)**
- 4- I pajisur me vulë/pullë nga **Stefano Paderni fu Giovanni Noter në Locri**  
Noter në Locri  
Vërtetuar:
- 5- Në **Locri**
- 6- Më, **10 shkurt 2022**
- 7- Nga **Dr. Luigi D'ALESSIO**, Prokuror i Republikës në Locri
- 8- Numër: **24/2022** i Regjistrimit të vulës Apostile
- 9- Vula
- 10- Firma  
**Luigi D'ALESSIO**,  
Prokuror i Republikës f.f

Përktheu: Valentina JAUPI

*Valentina Jaupi*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER RIDVANA G. RUÇI**



**DATE 28/02/2022  
NR REP 1134**

**VËRTETIM PËRKTHIMI**



Vertetoj nënshkrimin e përkthyesit Znj Valentina Jaupi, e bija biri e Hysen, lindur më 09/10/1967, në Dames, Fier dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim/pasaportë me nr. 034830034 dhe Nr. Personal G76009035Q, përthyes i licensuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila deklaroi se perktheu njësoj me originalin dokumentin bashkalidhur nga gjuha italiane në gjuhën shqipe.

Unë, noterja, duke gjetur këtë akt në përputhje me ligjin, e vërtetoj atë, në bazë të nenit 135 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.



**NOTER**  
**Ridvana Ruçi**